

# NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË SAJ

## POSTA SHQIPTARE SHA

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË  
ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri                                      Posta Shqiptare SHA  
Adresa                                    Rruga “Reshit Çollaku” nr. 4, Tiranë  
Tel/Fax                                    042 222 315  
E-mail                                      lindita.mulaj@postashqiptare.al  
Ueb-faqe                                  ëëë.postashqiptare.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri                                      Lindita Mulaj  
E-mail                                    lindita.mulaj@postashqiptare.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur”.

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër: Realizimi i punimeve

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-32851-12-11-2024

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rikonstrukcion Zyra e Administratës Filiali Gjirokastër”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45210000-2                      (Punime ndërtimi);

8. Fondi limit: 9.000.000 (nëntë milion) lekë pa T.V.SH

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:  
Mbështetur në nenin 127 “Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) pika 1, gërma c) , parashikon:

1. Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme:

c) “Në këtë rast, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një përshkrim të ndryshimeve, arsyet dhe rrethanat të cilat autoriteti ose enti kontraktor nuk mund t’i parashikonte gjatë dhënies së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër, si dhe një shpjegim se përse këto modifikime nuk ndryshojnë natyrën e kontratës ose të marrëveshjes kuadër.”.

Me kërkesën e paraqitur me datë 24.02.2026, BOE “Eurobeton” sh.p.k., & “Ina” sh.p.k, me objekt shtyrje afati të përfundimit të punimeve për shkak të kushteve atmosferike të pafavorshme.

Kërkesa e sipërcituar është shqyrtuar dhe vlerësuar nga mbikqyrësi i punimeve me shkresën nr.2484/24 Prot., datë 25.02.2026, gjithashtu dhe Specialisti i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, i cili me relacionin nr.2484/25 Prot., datë 27.02.2026 ka relatuar se;

Nga analiza e kërkesës së paraqitur, dokumentacionit shoqërues, si dhe nga verifikimet e kryera në terren, rezulton se gjatë zbatimit të kontratës janë hasur rrethana, të cilat kanë ndikuar në devijimin e grafikut të miratuar të punimeve.

Konkretisht, zona ku po realizohet objekti është karakterizuar nga kushte atmosferike të pafavorshme dhe reshje të vazhdueshme shiu për një periudhë të konsiderueshme kohore. Këto kushte kanë pamundësuar zhvillimin normal të disa proceseve teknologjike, veçanërisht realizimin e hidroizolimit të tarracës, proces i cili kërkon kushte të thata dhe të qëndrueshme për garantimin e cilësisë dhe jetëgjatësisë së punimeve.

Ndërprerja e kësaj faze ka sjellë shtyrje zinxhir të fazave të tjera të lidhura funksionalisht me të, duke ndikuar në riorganizimin e vazhdueshëm të grafikut të punimeve dhe në uljen e përkohshme të rendimentit në kantier. Të gjitha këto të mbështetura me proces-verbale ndërprerje punimesh dhe proces-verbale fillim punimesh ndërmjet sipërmarrësit të punimeve dhe mbikqyrësit të punimeve.

Mbikqyrësi i punimeve BOE “2H STUDIO & ARENA” sh.p.k. me shkresën me Nr. 2484/24 prot., datë 07/12/2026 ka rënë dakord me kërkesën e sipërmarrësit të punimeve për zgjatjen e afatit të punimeve me një afat kohor prej 30 ditë kalendarike. Duke gjykuar nga vlerësimi teknik rezultoi se vonesat e krijuara burojnë nga faktorë objektivë, të paparashikueshëm dhe jashtë kontrollit të sipërmarrësit, dhe për rrjedhojë konsiderohen të justifikuar.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve:

Modifikim Kontrate: Në bazë të kërkesës nr.2484/24 Prot., datë 25.02.2026, të mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit të objektit: “Rikonstruksion Zyra e Administratës Filiali Gjirokastër”

Kontrata është nënshkruar me nr.2484/13/prot., datë 30.04.2025, fillimi i punimeve me datë 01.10.2025

Ky amendim kontrate kryhet vetëm për zgjatjen e afatit të përfundimit të dorëzimit të punimeve, vlera e kontratës mbetet e pandryshueshme.

Modifikimi nuk ndryshon natyrën e kontratës, objektin e saj, kushtet thelbësore, por kufizohet vetëm në zgjatjen e afatit kohor për përfundimin e punimeve.

Nga analizimi i ecurisë së punimeve dhe dokumentacionit mbështetës, rezulton se kontraktori ka garantuar mobilizimin e nevojshëm të personelit dhe mjeteve, ndërsa vonesa në dorëzim ka ardhur si pasojë e ndërprerjeve të detyruara për shkak të kushteve atmosferike, jashtë kontrollit të tij.

11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 6.931.077 (gjashtë milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa T.V.SH ose 8.317.293 (tetë milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë, me T.V.SH

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): S’ka ndryshime në vlerë

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: me afat 5 (pesë) muaj kalendarik nga data e fillimit të punimeve (01.10.2025),

Dhe afati i ri (nëse është rasti): 30 (tridhjetë) ditë kalendarike Data e re për përfundimin e punimeve: 01.04.2026

14. Emri dhe adresa e Operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri “EUROBETON” sh.p.k.,

Adresë: Godina 2-katëshe, nr. pasurie 19/5, Zona Kadastrale 8543 Gjirokastër;

NIPT-it: K23116602P;

Emri “INA” sh.p.k.,

Adresë: Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë;

NIPT-it: J61814009Ë;

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 27.02.2026

16. Burimi i financimit: Të ardhurat e shoqërisë

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: \_\_\_\_\_

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A;**  
**NJOFTIM PËR MODIFIKIMIN E KONTRATËS GJATË ZBATIMIT**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor:

Emri: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a;

Adresa: Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë;

Tel: +355 42 228 349, +355 42 239 295;

E-mail: info@kesh.al;

Ueb-faqe: www.kesh.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri: R.Hasa.

E-mail: hasar@kesh.al.

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur/Punë publike.

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër: Punë Publike/ Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësies të shprehura në Preventivin në Njësi.

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: Nr. REF- 75214-07-14-2023.